

**RREGULLORE E PËRGJITHSHME
PËR
CERTIFIKIMIN E SISTEMEVE TË MENAXHIMIT
KODI: FISA-RR-109**

TABELA E RISHIKIMEVE					
Nr.	Data e lëshimit	Përshkrimi	Hartoi Kons/DT	Kontrollo i Men.cil	Miratoi Admin
1	15.09.2023	Botimi i parë	M.Cukalla	Dhurata Lohja	Migena Buzra

PASQYRË E PËRMBAJTJES

1. Qëllimi
2. Fusha e zbatimit
3. Referencat
4. Përkufizime dhe shkurtime
5. Përgjegjësit
6. Përshkrimi
 - 6.1. Hyrje
 - 6.2. Kushtet e përgjithshme për dhënjen e certifikimit
 - 6.3. Skema e Certifikimit
 - 6.4. Certifikimi i kompanive me shumë vendndodhjeve
 - 6.5. Procedura e certifikimit
 - 6.5.1. Aplikim/Informimi fillestar
 - 6.5.2. Oferta dhe Kontrata
 - 6.5.3. Auditimi
 - 6.5.4. Vlerësimi dhe Vendimi për certifikim
 - 6.5.4.1. Lëshimi i certifikatës
 - 6.5.4.2. Regjistrimi i sistemit të certifikatave
 - 6.5.5. Mbikëqyrja e certifikimit
 - 6.5.6. Rinovimi i certifikimit
 - 6.6. Auditimet shtesë
 - 6.7. Ndryshimet
 - 6.8. Përfundimi, pezullimi, revokimi
 - 6.9. Ndryshime në fushën e aplikimit së certifikates
 - 6.10. Ankesat, apelimet dhe procesi gjyqësor
 - 6.11. Pronësia e raportit dhe certifikatës
 - 6.12. Njohja e certifikimit të lëshuar nga organizmat e tjerë certifikuese

6.13. Heqja dorë, pezullimi, revokimi i akreditimit

6.14. Data e hyrjes në fuqi dhe modifikimi i rregulloreve të certifikimit

1. QËLLIMI

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është të përshkruajë procesin e certifikimit në FISA për të vlerësuar Sistemet e Menaxhimit të Organizatave aplikuese sipas standardeve përkatëse ndërkombëtare dhe rregulloreve kombëtare.

Dispozitat e kësaj Rregulloreje kanë vlerë kontraktuale si për FISA ashtu edhe për Organizatën që aplikon për certifikim.

FISA është një Organizëm certifikimi që vlerëson konformitetin për pale të treta dhe nuk kryen shërbime konsulence për ngritjen ose përmirësimin e sistemeve të menaxhimit si dhe nuk realizon shërbimin e certifikimit për Organizma të tjera të Certifikimit. FISA nuk certifikon kompani, filiale ose pjesë të tyre me të cilët mund të ketë ortakëri.

FISA ka aplikuar për akreditim pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit në Shqipëri (DPA)

2. FUSHA E ZBATIMIT

Kjo rregullore certifikimi (së bashku me procedurat teknike për aktivitetet e certifikimit) zbatohet nga organizmi certifikues i Sistemeve të Menaxhimit FISA shpk. Organizmi certifikues u ofron kompanive të interesuara, shërbimet e Certifikimit dhe, nëse kërkohet, mbikëqyrje dhe ricertifikim të një sistemi menaxhimi referuar skemave ISO 9001, ISO 27001, ISO 20000-1.

Kjo rregullore certifikimi formalizon zbatimin e procedurës së certifikimit.

Kërkesat përkatëse bazohen në kërkesat e serisë së standardeve, ISO/IEC 17000 si dhe në skemën e certifikimit të zbatueshëm për objektin e vlerësimit të konformitetit.

3. REFERENCAT

ISO/IEC 17021-1:2015 *Vlerësimi i Konformitetit- Kërkesat për trupat që kryejnë auditimin dhe certifikimin e sistemeve të menaxhimit*

ISO/IEC 17000 Vlerësimi i Konformitetit. Fjalori dhe Parimet e Përgjithshme.

FISA -MC-01 Manuali i Cilësisë

4. PËRKUFIZIME DHE SHKURTIME

Trup certifikimi sistemesh

Adresa: Rruga Abdyl Frasheri, Nr 4/9+I, Tirana Albania. tel/fax:

E-mail

www.fisa.pro

4.1 Në këtë dokument nuk ka ndonjë përkufizim të veçantë. Përkufizimet kryesore sipas standardit ISO 17000:2004 “Vlerësimi i konformitetit – Fjalor dhe Parimet e përgjithshme” dhe ISO 17021:2015 “Vlerësimi i Konformitetit- Kërkesat për trupat që kryejnë ëauditimin dhe certifikimin e sistemeve të menaxhimit” janë:

Trup Certifikimi (TC): pale e tretë që vlerëson dhe certifikon sistemin e menaxhimit të organizatave në ekonomi kundrejt Standardeve të publikuara për sistemet e menaxhimit dhe çdo dokumentacioni shtesë të kërkuar nga vetë sistemi.

Proces certifikimi: Sistem me rregullat e veta procedurale dhe menaxheriale që çojnë në lëshimin e dokumentit të certifikimit dhe mbajtjes së tij në vazhdimësi.

Organizatë: Ndërmarrjet që kërkojnë certifikim për Sistemin e vet të Menaxhimit.

Marrëveshje: Çdo marrëveshje certifikimi që lidhet ndërmjet FISA-s dhe Organizatës për kryerjen e shërbimeve të certifikimit, çdo ndryshim në një Marrëveshje të tillë dhe të gjitha aktet ligjore ose të tjera në përgatitjen dhe/ose për zbatimin e asaj Marrëveshjeje.

Objekti i Vlerësimit të Konformitetit: Çdo material, produkt, instalim, proces, sistem ose person i veçantë ndaj të cilit zbatohet Vlerësimi i Konformitetit.

Vlerësimi i Konformitetit: Verifikimi që specifikon se kërkesat në lidhje me një produkt, proces, sistem menaxhimi, person ose organizmi janë përmbushur.

Rezultati i Vlerësimit të Konformitetit: Produkti i çdo Vlerësimi të Konformitetit (p.sh. një raport dhe/ose certifikatë) që mund të përfshijë një konstatim të Jo-konformitetit.

Skema e Vlerësimit të Konformitetit: Rregullat, procedurat dhe menaxhimi i Vlerësimit të Konformitetit në lidhje me Objektet e specifikuar të Vlerësimit të Konformitetit, për të cilat zbatohen të njëjtat Kërkesa të Specifikuara, rregulla dhe procedura specifike siç përcaktohet nga Pronari i Skemës.

Pronari i skemës: Personi juridik që zotëron dhe operon një Skemë të Vlerësimit të Konformitetit.

Kërkesa të specifikuar: Nevojat ose pritjet e deklaruara. Kërkesat e specifikuar mund të deklarohen në dokumente normative si rregulloret, standardet dhe specifikimet teknike.

Auditues: Personi që kryen Vlerësimin e Konformitetit.

Vëzhgues: Personi që shoqëron audituesin(ët) por nuk ndërhyr në Vlerësimin e Konformitetit, p.sh. mbikëqyrës nga FISA ose përfaqësues të Organit të Akreditimit, Autoritetit Rregullator ose Pronari të Skemës.

4.2 Shkurtime të përdorura:

FISA:	Shoqëria FISA shpk
SM:	Sistemi i Menaxhimit
TC:	Njësia certifikuese e FISA shpk
TCSM	Trup certifikuese e sistemeve të menaxhimit
SC:	Skemë certifikimi
SMC:	Sistemi i menaxhimit të cilësisë

Trup certifikimi sistemesh

Adresa: Rruga Abdyl Frasheri, Nr 4/9+I, Tirana Albania. tel/fax: E-mail

www.fisa.pro

SMSI: Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit

SMTI: Sistemi i menaxhimit të shërbimeve të teknologjisë së informacionit

5. PËRGJEGJËSIA

Përgjegjesi i TCSM është përgjegjës për të siguruar zbatimin e kërkesave të kësaj rregulloreje

Stafi i FISA dhe Organizata Kliente janë përgjegjës për zbatimin e kërkesave të kësaj rregulloreje.

6. PERSHKRIMI

6.1 Hyrje

FISA Sh.p.k. (këtej e tutje referuar si FISA) është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me zyrë të regjistruar në adresën rruga Abdyl Frasheri, Njësia Administrative 5, 1001, Tiranë, Shqipëri. FISA ofron shërbime për certifikimin e sistemeve të menaxhimit si dhe trajnim për Organizata në të gjithë sektorët ekonomikë me synimin që:

- T'u japë Organizatave aplikuese shërbime certifikuese për të përmbushur standardet kombëtare, evropiane dhe ndërkombëtare të sistemeve të menaxhimit për skema të ndryshme (ISO 9001, ISO 27001, ISO 20000-1) si dhe të mbajë regjistra të përditësuar të certifikatave të lëshuara me statusin e tyre të vlefshmërisë;
- Të zhvillojë veprimtari për formimin dhe promovimin e një "kulture të cilësisë".

Si pjesë e veprimtarive të organizmit të certifikimit, FISA u ofron klientëve shërbime certifikimi të konformitetit ndaj standardeve, direktivave evropiane apo rregulloreve të detyrueshme dhe trajnime. Veprimtaritë certifikuese kryhen, brenda fushave të akredituara, në përputhje me standardet përkatëse dhe dokumentave të tjera në dispozicion të publikut duke ruajtur parimin e pavarësisë dhe të paanshmërisë në gjykim.

FISA vepron konform me kërkesat e Standardit ISO/IEC 17021 duke respektuar parimet e saj:

- paanshmëri;
- kompetencë;
- përgjegjshmëri;
- transparencë;
- konfidencialitet;
- dhënie e përgjigjeve ndaj ankesave.
- qasje ndaj riskut

Më shumë informacion lidhur me shërbimet e FISA-s mund të gjendet në faqen e internetit www.fisa.pro dhe/ose duke kontaktuar FISA në adresën e postës elektronike: info@fisa.pro

6.2 Kushtet e përgjithshme për dhënjen e certifikimit

Të gjitha Organizatat, që kanë interes në marrjen e certifikatës për sistemin e vet të menaxhimit në përputhje me kërkesat e standardit referencë, mund të kërkojnë certifikim nga FISA. Për marrjen e këtij certifikimi aplikuesi duhet:

Trup certifikimi sistemesh

Adresa: Rruga Abdyl Frasheri, Nr 4/9+I, Tirana Albania. tel/fax:

E-mail

www.fisa.pro

a) Të ketë një sistem menaxhimi të dokumentuar në përputhje me kërkesat e standardit referues; klienti duhet ta ketë zbatuar sistemin të paktën tre muaj, ta ketë përditësuar dhe përshtatur;

b) Të demostrojë, gjatë certifikimit fillestar, që:

- Ka kryer ciklin e plotë të auditeve të brendshme;
- Ka kryer dhe dokumentuar të paktën një rishikim të sistemit të menaxhimit nga ana e menaxhimit të lartë;
- Ka përcaktuar një politikë të ndërmarrjes me synim caktimin e objektivave dhe proceseve dhe burimeve të nevojshme për të arritur konformitetin me standardin;
- Ka kryer dhe regjistruar monitorimin dhe matjen e proceseve dhe produkteve lidhur me politikat, objektivat dhe kërkesat për produktin/shërbimin;
- Ka planifikuar veprime për përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve;

c) Ka pranuar rregullat e vendosura në këtë rregullore dhe kushtet e komunikuara nga ana e FISA-s.

Pranimi i aplikimit, procesi i certifikimit, nxjerrja e certifikatës, mbajtja e saj, dhënia e autorizimit për përdorimin e logos lidhur me certifikimin kushtëzohen me shlyerjen e pagesave të dakordësuara. Mospërbushja e këtyre detyrimeve në afatin e caktuar sjell pezullimin apo tërheqjen e certifikatës në përputhje me kapitullin 9 të kësaj Rregulloreje.

6.3 Skema e Certifikimit

Organizmi certifikues përdor Skema certifikimi të përshkruara në standarde ndërkombëtare, të cilat janë adoptuar si standarde shqiptare, si dhe specifikime e kërkesa të shprehura në legjislacionin shqiptar për fushën përkatëse (udhëzime, ligje, urdhëresa, rregulla teknike, standarde, specifikime dhe kritere akreditimi etj.)

Organizmi certifikues nuk është pronar i skemës së certifikimit, por thjesht përdorues i saj.

Bashkëngjitur me këtë rregullore certifikimi jepen edhe kërkesat specifike sipas skemave të certifikimit që përdor organizmi certifikues.

Procedura e certifikimit përfshin hapat e mëposhtëm: "Auditimi", "Vlerësimi" dhe "Vendimi për certifikimin".

Hapi i "Auditimit" përfshin në këtë procedurë planifikimin dhe përzgjedhjen e fushës së aplikimit si dhe përcaktimin e rezultateve të auditimit. Rezultatet e auditimit përmbledhen në një raport auditimi.

Në hapin tjetër vlerësohen rezultatet e auditimit dhe merret vendimi për certifikimin me lëshimin e certifikatës. Gjatë marrjes së vendimit bëhet një vlerësim nëse sistemi përputhet me kërkesat e përcaktuara në skemën e certifikimit (ky hap referohet shkurt me termin "Certifikimi" në këtë rregullore certifikimi).

Nëse vetitë e sistemit përputhen me kërkesat (konformiteti), lëshohet certifikata (certifikata e konformitetit).

6.4 Certifikimi i kompanive me shumë vendndodhjeve:

Certifikimi i kompanive me shumë vendndodhje mund të aplikohen për organizata që kryejnë aktivitetin e tyre në shumë vendndodhje ose degë që funksionojnë ekskluzivisht si zyra në terren.

Certifikimi në shumë vende është i mundur nëse plotësohen kriteret e mëposhtme:

- Të gjitha vendet mbajnë një marrëdhënie ligjore ose kontraktuale me selinë qendrore të aplikantit.
- Produktet/shërbimet janë në thelb identike në të gjitha vendet dhe prodhohen duke përdorur

Trup certifikimi sistemesh

Adresa: Rruga Abdyl Frasheri, Nr 4/9+1, Tirana Albania. tel/fax:

E-mail

www.fisa.pro

metoda dhe procese identike.

- Është përcaktuar një sistem uniform menaxhimi dhe është ngritur dhe mirëmbahet për të gjitha degët/objektet e prodhimit.
- I gjithë sistemi i menaxhimit monitorohet në mënyrë qendrore nën drejtimin e Menaxherit të Cilësisë në zyrën qendrore të aplikantit, i cili është i autorizuar të lëshojë udhëzime në lidhje me sistemin e menaxhimit për të gjitha degët/vendet e prodhimit.
- Auditimet e brendshme dhe rishikimet e menaxhimit janë kryer në të gjitha zyrat e degëve.
- Zona të caktuara kryejnë aktivitete të centralizuara në emër të të gjitha degëve/siteve të prodhimit, p.sh. dizajni dhe zhvillimi i produktit dhe procesit, blerja, burimet njerëzore (HR), etj.

Në rastet që përfshijnë certifikimin në shumë vende, auditimi në vend i vendndodhjeve mund të shpërndahet në kontrollet e certifikimit dhe mbikëqyrjes. Zyrat qendrore duhet të auditohen çdo vit, përveç vendeve të kampionuara.

Organizmi certifikues zgjedh vendet që do të auditohen.

6.5 Procedura e certifikimit

Procedura e certifikimit ndjek aktivitetet e dhëna në fig.1

6.5.1 Aplikim/Informimi fillestar

Aplikanti i interesuar merr nje informacion nga trupi certifikues për procedurën e certifikimit pasi plotëson dhe dorëzon një formular ("Kërkesë për Ofertë") të ofruar nga organizmi certifikues.

Organizmi certifikues kërkon detajet dhe informacionin e mëposhtëm në lidhje me aplikantin:

- Emri dhe adresa e aplikantit dhe emri i kontaktit
- Lloji i certifikimit (Çertifikim i parë/mbikëqyrje/ri-certifikim/modifikim)
- Skema e certifikimit, standardi dhe fusha e mundshme e aplikimit: përshkrimi i sistemit (produkt/proces/ shërbim); detajet e kërkesave të sistemit të menaxhimit (standardet, specifikimet)
- Detaje rreth vendndodhjeve të kompanisë së aplikantit
- Personeli, pajisjet, proceset (proceset e prodhimit), detaje në lidhje me nënkontraktorët dhe të çdo certifikate të mbajtur tashmë.
- organizmi/personi që ka kryer konsulencën.
- Koha e parashikuar nga kompania për realizimin e auditit




Figura 1

6.5.2 Oferta dhe Kontrata

Organizmi certifikues vendos, në bazë të kërkesës për ofertë të paraqitur nga aplikanti, nëse në parim është e mundur fillimi i një procedure certifikimi në përputhje me programin e certifikimit. Aplikanti informohet nëse nuk mund të kryhet një procedurë certifikimi.

Nëse mund të kryhet procedura e certifikimit, FISA bën një ofertë, duke përcaktuar shërbimet individuale, çmimet dhe kushtet, bazuar në qëllimin e certifikimit për të cilin aplikohet, tarifat e vendosura dhe llogaritjet e bëra nga organizmi certifikues për aplikimin, certifikimin fillestar dhe mirëmbajtjen e certifikimit për një cikël të plotë të vlefshmërisë së certifikimit. Oferta i dërgohet aplikantit.

Ofertës i bashkangjiten Dokumentat e mëposhtme të detyrueshme për zbatim:

- "Rregullore Certifikimit të Sistemeve të Menaxhimit" të FISA-s, së bashku me rregulloret specifike të skemës së certifikimit
- "Termat dhe kushtet e përgjithshme të biznesit të FISA-s" së bashku me kushtet tregtare.

Ofertës i bashkëngjitet edhe një "kontratë". Për të aplikuar për shërbimet e certifikimit të ofruara, aplikanti nënshkruan Ofertë-kontratën dhe ia dërgon atë organit të certifikimit dhe merr në këmbim Ofertë-Kontratën e firmosur nga organi certifikues. Duke firmosur ofertë-kontratën, aplikanti pranon si të detyrueshme kushtet teknike të përcaktuara në këtë rregullore certifikimi. Marrëdhëniet ekzistuese kontraktuale i nënshtrohen ndryshimeve në rregulloren e certifikimit.

Ndryshimet në ofertë ose kontratë mund të bëhen vetëm me shkrim.

Çdo paqartësi nga ana e organizmit certifikues dhe aplikantit duhet të sqarohet.

Çdo dallim në perceptimet e organizmit certifikues dhe aplikantit duhet të zgjidhet.

Nëse shihet e nevojshme, TC mund të kryejë një parauditim për të bërë një analizë fillestare të performancës ose mangësive, duke identifikuar pikat e forta dhe fushat për përmirësim.

6.5.3 Auditimi

Organizmi certifikues ngarkon një ekip auditimi, të autorizuar prej tij, për të kryer auditimin përkatës të sistemit të menaxhimit.

Për përgatitje për auditim, aplikanti duhet t'i dorëzojë paraprakisht organizmit certifikues dokumente specifike, regjistrime dhe verifikime të specifikuara në skemën e certifikimit (shih. Shtojcën 1). Dokumentet

Trup certifikimi sistemesh

Adresa: Rruga Abdyl Frasheri, Nr 4/9+I, Tirana Albania. tel/fax:

E-mail

www.fisa.pro

duhet të jenë në gjuhën shqip, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në aktmarrëveshje. Aplikanti duhet të verë në dispozicion të grupit të auditimit të FISA shpk, dokumentacionin e mëposhtëm:

- Informacioni i dokumentuar i kërkuar nga standardi i referencës dhe / ose ai që konsiderohet i nevojshëm nga kompania për të garantuar efektivitetin e sistemit të menaxhimit
- kopje të certifikatës së regjistrimit të biznesit ose dokument ekuivalent, si dëshmi për ekzistencën e kompanisë dhe veprimtarinë e kryer;
- organigrama organizative e kompanisë;
- rishikimi i fundit i Menaxhimit;
- planifikimi i auditimeve të brendshme;
- listën e ligjeve kryesore dhe / ose rregulloreve të zbatueshme (për produktin / shërbimin e ofruar ose të domosdoshëm për aplikimin korrekt të Sistemit të Menaxhimit);
- lista e kantierëve të perkohshëm / aktiviteteve jashtë kompanisë në vazhdim, me një përshkrim të aktiviteteve të kryera atje, aty ku është e aplikueshme.

FISA mund të kërkojë, sipas gjykimit të saj, për ekzaminim, dokumente të tjera përveç atyre të përmendura më lart, që konsiderohen të rëndësishme për qëllimet e vlerësimit të Sistemit të Menaxhimit.

Auditimi përfshin verifikimin e dokumenteve të dorëzuara si dhe auditimin në vendndodhjen e kompanisë së aplikantit. Aplikantit i dërgohet një plan auditimi, i cili e njofton atë për procedurën dhe qëllimin e auditimit. Auditimi mbulon pikat e specifikuar në skemën e certifikimit. Auditimi kryhet nga grupi i auditimit në përputhje me planin e auditimit.

Faza 1 e auditimit fillon me rishikimin dhe vlerësimin e dokumentacionit të sistemit, qëllimeve, rezultateve të rishikimit të menaxhimit dhe auditimeve të brendshme. Gjatë këtij procesi do të përcaktohet nëse sistemi i menaxhimit të klientit është mjaftueshëm i zhvilluar dhe i gatshëm për certifikim. Vlerësuesi do të shpjegojë gjetjet dhe do të koordinojë çdo aktivitet të kërkuar për t'u përgatitur për auditimin e Fazës 2. Faza e parë e auditimit kryhet vetëm për certifikimin fillestar. Faza e parë e auditimit mund të kryhet:

- pjesërisht në zyrë dhe pjesërisht në vendndodhjen e kompanisë ose
- plotësisht në vendndodhjen e kompanisë

Për realizimin e auditit faza 1, një nga anëtarët e grupit të auditimit mund ta realizojë auditin në distancë i asistuar nga anëtarët e tjerë të grupit që ndodhen në site.

Faza 2 e Auditimit: Ekipi i caktuar i auditorëve do të auditojë sistemin e menaxhimit të klientit në vendin e prodhimit ose ofrimit të shërbimit dhe/ose duke përdorur teknikat e auditimit në distancë. Duke zbatuar standardet dhe specifikimet e përcaktuara të sistemit të menaxhimit, ekipi i vlerësimit do të vlerësojë efektivitetin në të gjitha proceset e sistemit të menaxhimit, bazuar në vëzhgimet, inspektimet, intervistat, rishikimin e të dhënave përkatëse dhe teknikat e tjera të vlerësimit. Ekipi i auditimit do të regjistrojë çdo mundësi për përmirësim të vërejtur gjatë auditimit të sistemit. Rezultati i auditimit, duke përfshirë të gjitha gjetjet do t'i prezantohet klientit gjatë takimit përmbyllës

Nëse kërkesa specifike të auditimit nuk plotësohen, ekipi i auditimit do ta regjistrojë këtë si "jokonformitet". Çdo mospërputhje e zbuluar duhet të korrigjohet nga aplikanti në një periudhë të arsyeshme kohore me veprimet e duhura korrigjuese. Planet e nevojshme të veprimeve korrigjuese do të dakordësohen nga ekipi i auditorëve. Evidenca që korrigjimi është kryer duhet t'i paraqitet ekipit të auditimit. Ekipi i auditimit mund të

Trup certifikimi sistemesh

Adresa: Rruga Abdyl Frasheri, Nr 4/9+I, Tirana Albania. tel/fax:

E-mail

www.fisa.pro

kryejë gjithashtu një ri-auditim në rast të mospërputhjeve serioze/të palejueshme (p.sh. nëse personeli nuk ka kualifikimet e kërkuara, mungesa e pajisjeve, etj).

Në këtë riauditim, grupi i auditimit kontrollon nëse moskonformitetet janë korrigjuar në mënyrë efektive nga masat korrigjuese të marra.

Ekipi i auditimit i paraqit rezultatet e auditimit (duke përfshirë çdo mospërputhje të gjetur) në një raport me shkrim (raport auditimi) i cili i dorëzohet aplikantit.

6.5.4 Vlerësimi dhe Vendimi për certifikimin

Në rastet kur, gjatë auditimit, grupi i auditimit nuk ka patur kundërshtime dhe të gjitha mospërputhjet e zbuluara janë korrigjuar, raporti i auditimit i përcillet me dokumentet përkatëse një organi të pavarur, Komitetit të Certifikimit.

Komiteti i Certifikimit e vlerëson raportin për konformitet ndaj kërkesave të standardit (vlerësim formal dhe teknik).

Nëse kërkesat nuk plotësohen, certifikata nuk lëshohet dhe aplikanti informohet me shkrim nga organi certifikues për vendimin për moslëshimin e certifikatës dhe për arsyet e vendimit.

6.5.4.1 Lëshimi i certifikatës

Nëse plotësohen kërkesat dhe nëse vërtetohet konformiteti, certifikata lëshohet dhe i dorëzohet aplikantit. Certifikata e lëshuar, përveç informacioneve të tjera, tregon datën e ricertifikimit dhe të skadimit, afatin brenda të cilës duhet të përfundojë procesi i rinovimit, duke përfshirë vendimarrjen pozitive të praktikës, në mënyrë që të ruhet historiku dhe numri i Certifikatës.

Certifikata e lëshuar nga FISA shpk lëshohet në gjuhën e kontraktuar; certifikatat në gjuhë të tjera mund të lëshohen sipas kërkesës të klientit të shprehur në ofertën e certifikimit. Afati i vlefshmërisë së certifikatës është tre vite.

Certifikata e lëshuar, si dhe raportet e auditimit, janë në pronësi të FISA shpk dhe Shoqëria kliente pranon t'i kthejë ato në rast të ndryshimeve/anulimeve; E drejta e Shoqërisë për përdorimin e logos /certifikatës të FISA shpk bëhet në përputhshmëri të plotë dhe të vazhdueshme me kërkesat për sistemin e certifikuar dhe me rregulloren e përdorimit të logos/certificates, që i përcillet Shoqërisë kliente (elektronikisht ose në format letër) gjatë procesit të lidhjes së kontratës si dhe në kohën e lëshimit të Certifikatës.

Shoqëria kliente duhet të ndërpresë menjëherë referencën ndaj certifikatës FISA dhe logon e certifikimit

(i) pas skadimit, pezullimit, anulimit të certifikatës,

(ii) në rast se janë bërë ndryshime në sistem të papranuara nga FISA shpk,

(iii) nëse FISA shpk ndryshon rregullat e skemës së certifikimit dhe Shoqëria kliente nuk ka ndërmend t'i respektojë,

(iv) në prani të çdo rrethane tjetër që mund të ndikojë negativisht në sistemin e certifikatave.

6.5.4.2 Regjistrimi i sistemit të certifikatave

Të dhënat në lidhje me certifikatat e lëshuara raportohen në një regjistër të disponueshëm për publikun dhe, kur jepen, njoftohet organi i akreditimit. Lëshimi i certifikatës regjistrohet në një bazë të dhënash që me kalimin e kohës identifikon edhe statusin e saj (i vlefshëm - i pezulluar - i hequr). Informacioni mbi

vlefshmërinë e secilës Certifikatë të lëshuar mundet t'u jepet palëve të treta pas një kërkesë specifike dhe të arsyetuar.

6.5.5 Mbikëqyrja e certifikimit

Vlefshmëria e certifikimit dhe përputhshmëria me kërkesat e skemës së certifikimit monitorohen në intervale të rregullta nga organizmi certifikues, sipas programit të certifikimit (shih. Shtojcën 1). Në këtë proces kërkohen auditime mbikëqyrëse në intervale të caktuara. Auditimet e mbikëqyrjes sigurojnë mirëmbajtjen korrekte të sistemit të certifikuar referuar veçanërisht efektivitetit të sistemit dhe zbatimit të programeve të përmirësimit të vazhdueshëm. Datat e planifikuara të auditimit përcaktohen duke iu referuar datës së përfundimit të fazës 2 ose ndryshimeve të mëvonshme. Data e kryerjes së auditimeve të mbikëqyrjes pas lëshimit fillestar nuk duhet të jetë më shumë se 12 muaj nga data e përfundimit të Fazës 2. Çdo vit kalendarik duhet të kryhet të paktën një audit mbikëqyrjeje ose rinovimi.

Organi certifikues ngarkon një ekip të autorizuar auditimi për të kryer vlerësimin përkatës. Auditimi i mbikëqyrjes kryhet në përputhje me procedurën e përshkruar në fazën e dytë të auditimit në pikën 6.5.3, me theks të veçantë gjithashtu në kontrollin e efektivitetit të masave të marra për korrigjimin e mospërputhjeve të mëparshme. Pas përfundimit të vizitës, Shoqëria kliente merr raportin përkatës të auditimit.

Organizmi certifikues vendos në bazë të raportit të auditimit nëse certifikimi duhet të mbahet, pezullohet apo edhe të hiqet. FISA shpk, në rast të ndryshimit të përfundimeve të auditimit, të rekomanduar në raport, njofton Shoqërinë kliente për vendimin e marrë dhe veprimet që duhen ndërmarrë. Në rastet kur një veprim i tillë është i justifikuar, për shembull kur janë bërë ankesa dhe apeline, organi certifikues mund të kërkojë gjithashtu që të kryejë auditime të veçanta mbikëqyrëse.

6.5.6 Rinovimi i certifikimit

Gjatë mbikëqyrjes së fundit të çdo cikli certifikimi (zakonisht tre vjet, në varësi të standardit referues), stafi i FISA shpk shpjegon kriteret e rinovimit për një cikël shtesë. Në varësi të marrëveshjes fillestare të lidhur me FISA shpk, mund të lidhet një kontratë e re trevjeçare ose mund të konfirmohet ajo ekzistuese. Në rastin e fundit, mund të zbatohet çdo ndryshim në termat e referencës kontraktuale të komunikuara paraprakisht Shoqërisë kliente. Procedura për rinovimin ndjek hapat e mëposhtëm:

- Aplikimi
- Auditimi
- Vlerësimi dhe vendimi për certifikim
- Mbikëqyrja

Auditimi për ricertifikim, në prani të një kontrate të vlefshme ndërmjet palëve, planifikohet nga FISA shpk, shumë përpara skadimit të certificates. Mos përfundimi i procesit të rinovimit të certifikatës brenda afatit kohor, duke përfshirë edhe vendimmarrjen pozitive të praktikës, do të çojë në anulimin e certifikatës së mëparshme dhe, nëse plotësohen kërkesat, do të lëshohet një certifikatë e re (me numër të ri dhe lëshim të ri të certifikatës pa vazhdimësi historike). Data e hyrjes në fuqi e certifikatës së re do të jetë ajo e vendimit të ricertifikimit dhe data e skadencës do të bazohet në atë të ciklit të mëparshëm të certifikimit.

Trup certifikimi sistemesh

Adresa: Rruga Abdyl Frasheri, Nr 4/9+1, Tirana Albania. tel/fax:

E-mail

www.fisa.pro

Për të bërë të mundur planifikimin paraprakisht të vizitës për rinovim, kërkesa për ofertë në FISA shpk duhet të bëhet të paktën 3 (tre) muaj përpara skadimit të certifikatës aktuale.

Në vizitën e rinovimit, verifikohet angazhimi i Shoqërisë për mirëmbajtjen e sistemit, efektivitetin e sistemit dhe përputhshmërinë e vazhdueshme të tij me fushën e aplikimit, të para edhe në dritën e rezultateve të marra gjatë gjithë ciklit pararendës të certifikimit.

FISA shpk, në rast të një ndryshimi në konkluzionet e auditimit, të rekomanduar në raport, njofton Shoqërinë kliente për vendimet e marra dhe veprimet që duhen ndërmarrë.

6.6 Auditimet shitesë

FISA shpk rezervon të drejtën për të kryer auditime shitesë, duke e arsyetuar me shkrim për Shoqërinë kliente. Kjo mund të bëhet, për shembull, për të verifikuar implementimin e shumë veprimeve korrigjuese, për të trajtuar çdo kërkesë që është shfaqur gjatë lëshimit të certifikatës, për anulimin e pezullimit të certifikatës, kur merren raporte për keqfunksionime serioze ose ankesa në lidhje me sistemin e certifikuar, kur Shoqëria kliente bën ndryshime në sistemin e saj, të cilat konsiderohen të qënësishme nga FISA shpk, etj. Në fund të vizitës, Shoqëria kliente merr raportin përkatës. FISA shpk rezervon gjithashtu të drejtën për të kryer vizita të paparalajmëruara, nëse është e nevojshme, duke justifikuar arsyet për kryerjen e tyre.

Të gjitha shpenzimet në lidhje me çdo auditim shitesë, që rezulton nga mangësitë në Sistemin e Menaxhimit i ngarkohen Kompanisë.

Mund të bëhen vizita shitesë, të shkëputura nga FISA shpk, nga Drejtoria e Akreditimit ose persona të caktuar prej saj.

Nëse Shoqëria kliente refuzon të pranojë auditime të tilla, fillon automatikisht procesi i pezullimit dhe/ose heqjes së certifikatës.

6.7 Ndryshimet

Nëse kërkesat e certifikimit ndryshojnë (p.sh. për shkak se skema e certifikimit mbi të cilin bazohet certifikimi është rishikuar), trupi certifikues do të informojë aplikantin në kohën e duhur për këto ndryshime, si dhe për çdo masë rregulluese që duhet të merret sëbashku me afatet kohore. Mos përshtatja e Shoqërisë ndaj veprimeve korrigjuese të vendosura, brenda afatit kohor të rënë dakord, mund të çojë në implementimin e masave të pezullimit/heqjes së certifikimit.

Nga ana tjetër, gjithashtu, mund të ndodhin ndryshime në kompaninë e aplikantit, të tilla si:

- ndryshime në aspekte ligjore, tregtare, organizative ose të pronësisë,
- ndryshime në organizim dhe menaxhim (p.sh. personeli me role kyçe ose vendimmarrës, personeli teknik)
- adresat e kontaktit dhe vendndodhjet
- ndryshime të qënësishme në fushën e aplikimit të sistemit
- ndryshime të proceseve në sistemin e menaxhimit të certifikuar

Aplikanti duhet të njoftojë menjëherë organizmin certifikues për çdo ndryshim në kompaninë e tij/saj që ndikon në certifikim.

Trup certifikimi sistemesh

Adresa: Rruga Abdyl Frasheri, Nr 4/9+I, Tirana Albania. tel/fax:

E-mail

www.fisa.pro

Edhe në këtë rast organizmi certifikues do të informojë aplikantin për masat që duhen marrë për zgjerimin ose reduktimin e fushës së certifikimit. Organizmi certifikues do të kontrollojë dhe verifikojë masat e marra nga aplikanti. Procedura ndjek hapat e mëposhtëm:

- Aplikimi
- Auditimi
- Vlerësimi dhe vendimi për certifikimin
- Mbikëqyrja

6.8 Përfundimi, pezullimi, revokimi

Kur janë identifikuar shkelje të skemës së certifikimit, të rregullores së certifikimit, të rregullores së përdorimit të certifikatës dhe logos së FISA-s, të marrëveshjes kontraktuale, etj., organi certifikues mund t'i kërkojë aplikantit të marrë masat e duhura korrigjuese.

Në raste ekstreme vlefshmëria e një certifikimi mund të skadojë ose pezullohet, kufizohet ose të hiqet.

Një certifikatë skadon nëse:

- periodha e vlefshmërisë së treguar në certifikatë ka skaduar dhe nuk është zgjatur
- urdhri për certifikim është anuluar nga organi certifikues ose aplikanti pas 3 muajve të dhënjes të njoftimit për anulim.
- aplikanti heq dorë nga certifikata
- aplikanti falimenton
- kanë ndryshuar rregulloret mbi të cilat është bazuar certifikata

Një certifikatë mund të kufizohet, pezullohet ose hiqet nga organi certifikues nëse:

- ndodhin mospërputhje ndaj kërkesave të certifikimit pas lëshimit të certifikatës
- aplikanti refuzon të lejojë mbikëqyrjen ose nuk mundëson kryerjen e tij dhe nuk lejon organin certifikues të kryejë mbikëqyrje pavarësisht një kërkesë me shkrim
- certifikata (ose logo e certifikimit) përdoret në çdo mënyrë që mund të mashtrojë, ose kryhet reklamim i palejueshëm duke përdorur certifikatën (ose logon e certifikimit)
- Kanë dalë në dritë fakte që nuk mund të zbuloheshin në momentin e lëshimit të certifikatës.
- Masat korrigjuese të nevojshme për korrigjimin e mospërputhjeve nuk janë marrë në një afat kohor të arsyeshëm ose të caktuar
- Tarifat që i detyrohen organit certifikues nuk janë paguar edhe pas një rikujtese në afatet kohore të caktuara.

Përpara shpalljes së një certifikate të pezulluar ose të pavlefshme, organizmi certifikues do t'i japë aplikantit mundësinë për të paraqitur anën e tij/saj të çështjes, përveç rastit kur një seancë e tillë nuk mund të justifikohet për shkak të urgjencës së masave që duhet të merren.

Kohëzgjatja maksimale e pezullimit të certifikates, në përgjithësi nuk i kalon 6 (gjashtë muaj), e llogaritur nga data e kryerjes së vizitës së planifikuar. Nëse arsyet e pezullimit korrigjohen brenda periudhës kohore të rënë dakord, certifikimi do të rijepet. Nëse arsyet e pezullimit nuk korrigjohen brenda periudhës kohore të rënë dakord, certifikata do të tërhiqet.

Organi certifikues mund t'i kërkojë aplikantit të kthejë certifikatën kur tërheq certifikimin.

Trup certifikimi sistemesh

Adresa: Rruga Abdyl Frasheri, Nr 4/9+I, Tirana Albania. tel/fax:

E-mail

www.fisa.pro

Organizmi certifikues do të publikojë skadimin ose heqjen e certifikimit sipas rastit dhe ka të drejtë të informojë organe të caktuara si organin e akreditimit ose autoritetet/autoritetet e mbikëqyrjes që lëshojnë autorizimin për lëshimin, skadimin ose revokimin e certifikatave. Organizmi certifikues nuk është përgjegjës për çdo dëm që mund të pësojë aplikanti për shkak se nuk është dhënë një certifikatë ose për shkak se një certifikatë ka skaduar ose është anuluar.

6.9 Ndryshime në fushën e aplikimit së certifikatës

Shoqëria kliente mund të kërkojë zgjerim të fushës së vlefshmërisë së certifikatës (për shembull, për futjen e produkteve, proceseve, shërbimeve, fabrikave të reja, etj në krahasim me ato të përmendura në certifikatë) duke ndjekur procedurën e përshkruar për certifikim fillestar. Zgjerimi i fushës jepet pas një auditimi të ri të suksesshëm që përfshin elementët e mbuluar nga zgjerimi. Kohëzgjatja varet nga rëndësia e kërkesave dhe mund të rezultojë në një përsëritje të plotë të procesit të certifikimit. Më pas lëshohet një certifikatë e re, e cila zëvendëson certifikatën e vjetër.

Në mënyrë të ngjashme, FISA shpk mund të marrë masa për reduktimin e vlefshmërisë së certifikatës pas komunikimit Shoqërisë kliente, si rezultat i pranisë së jokonformiteteve të pazgjidhura në kohë dhe/ose të lidhura me aspekte specifike, përjashtimi i të cilave nuk ndikon në pjesën tjetër të sistemit ose në mungesë të aktiviteteve të lidhur me produktin/procesin e certifikuar.

6.10 Ankesat, apelimet dhe procesi gjyqësor

Ankesat me shkrim mund të dorëzohen në FISA shpk nga klientët e saj (p.sh. në lidhje me sjelljen e stafit) ose nga klientët e Shoqërive kliente të certifikuar, Organizmi i akreditimit, apo palët e tjera të interesuara, etj. Shoqëria kliente, që përdor shërbimet e certifikimit të ofruara nga FISA shpk, ka gjithashtu të drejtën të parashtojë apelim me shkrim kundër vendimeve të marra ndaj saj nga FISA shpk (p.sh. për mos lëshimin e certifikimit).

Me marrjen e ankesave ose apeliemeve, FISA shpk konfirmon me shkrim se i ka marrë ato dhe merr përsipër, në përputhje me procedurën e saj të brendshme, të vlerësojë dhe të marrë një vendim, nëpërmjet një stafi të kualifikuar dhe të pavarur.

6.11 Pronësia e raportit dhe certifikatës (pronësia intelektuale)

Çdo dokument, duke përfshirë çdo raport ose certifikatë të nxjerrë nga FISA shpk, dhe e drejta e autorit, që përfshihet aty, mbeten pronë e FISA shpk dhe Shoqëria kliente, në asnjë mënyrë, nuk duhet të ndryshojë ose keqinterpretojë përmbajtjen e tij.

Shoqëria kliente do të lejohet të bëjë kopje vetëm për përdorim të brendshëm dhe kopjet e certifikatave janë të disponueshme sipas kërkesës.

6.12 Njohja e certifikimit të lëshuar nga organizmat e tjerë certifikuese

FISA shpk njeh certifikatat e lëshuara nga organizma të tjerë certifikues, të akredituar nga organizma të njohur të akreditimit dhe që janë pjesë të marrëveshjeve së njohjes reciproke IAF / MLA, përveç rasteve kur këto komprometojnë integritetin e skemës së certifikimit të miratuar nga FISA shpk.

Trup certifikimi sistemesh

Adresa: Rruga Abdyl Frasheri, Nr 4/9+I, Tirana Albania. tel/fax:

E-mail

www.fisa.pro

Nëse një kompani, me certifikatë të vlefshme, dëshiron të transferojë certifikimin e vet tek FISA, ai duhet të dërgoj te plotësuar "Formularin e aplikimit" si dhe një kopje të certifikatës së Sistemit të Menaxhimit. FISA lëshon ofertën ekonomike për transferimin e certifikimit, pasi verifikon nëse:

- Certifikata është e vlefshme/Certifikata nuk është e pezulluar
- Organizmi certifikues që ka lëshuar certifikatën nuk është pezulluar
- Aktivitetet e certifikuara bien në fushën e akreditimit të FISA-s
- Kompania ka justifikuar kërkesën për transferim.

Më pas, kompania, në rast pranimi të ofertës ekonomike, duhet të dërgojë "Kërkesën për certifikim" dhe të vere ne dispozicion të FISA-s dokumentet e mëposhtme:

- kopje të raportit të auditimit fillestar / të raportit të auditimit të ricertifikimit të fundit dhe të raporteve të auditimit të mbikëqyrjeve pasuese.
- dëshmi të veprimeve korrigjuese të ndërmarra për të zgjidhur jo-konformitetet e zbuluara gjatë auditimeve të mëparshme ose dëshmi për verifikimin e zbatimit dhe efektivitetit të tyre nga organi që kishte lëshuar certifikatën.
- Lloji dhe datat e auditimeve të ardhshme të planifikuara nga Organi i Certifikimit të mëparshëm
- Lista e ankesave të pranuar dhe veprimeve të ndërmarra
- Arsyet për të kërkuar transferimin e certifikimit
- Çdo vërejtje ose raporte të marra nga autoritetet kombëtare ose lokale përgjegjëse

Verifikimi i dokumentacionit të mësipërm zakonisht përfshin një vizitë në kompanin që kërkon transferimin e certifikimit.

Pas përfundimit të aktivitetit të sipërpërmendur me një rezultat të favorshëm, lëshohet një certifikatë konformiteti për sistemin e menaxhimit në fjalë, i cili, si rregull, e mban afatin e caktuar tashmë nga organi që ka lëshuar certifikimin e mëparshëm. Në përgjithësi, programi i krijuar tashmë nga Trupi që ka lëshuar certifikimin e mëparshëm mbahet edhe për ekzekutimin e auditimeve të mbikëqyrjes dhe ricertifikimit të Sistemit.

Në rast se kushtet për transferimin nuk plotësohen, procedura e transferimit nuk mund të zbatohet; kompania që synon të vazhdojë me procesin e certifikimit do të vlerësohet duke zbatuar kriteret e përcaktuara në Kapitullin 2 "CERTIFIKIMI FILLESTAR".

6.13 Heqja dorë, pezullimi, revokimi i akreditimit

FISA shpk është e angazhuar të informojë në kohën e duhur organizatën e klientit për heqjen dorë/pezullimin/revokimin e mundshëm të akreditimit në skemën/sectorin e akreditimit, në të cilin është kryer certifikimi i Shoqërisë, si dhe të mbështesë vetë shoqërinë në fazën e kalimit në një organizëm tjetër të akredituar.

6.14 Data e hyrjes në fuqi dhe modifikimi i rregulloreve të certifikimit

Nëse dispozitat individuale të këtyre rregulloreve të certifikimit bëhen joefektive, vlefshmëria e çdo dispozite tjetër nuk ndikohet nga kjo. Organizmi certifikues dhe aplikanti do të zëvendësojnë dispozitat e njohura si joefektive me dispozita efektive, të cilat përafrojnë më shumë me dispozitën e synuar.

Trup certifikimi sistemesh

Adresa: Rruga Abdyl Frasheri, Nr 4/9+I, Tirana Albania. tel/fax:

E-mail

www.fisa.pro

Organizmi certifikues ka të drejtë të kërkojë një gjobë kontraktuale deri në nëse konstatohet se aplikanti i ka shkelur me dashje këto rregulla të certifikimit, veçanërisht nëse ai/ajo ka përdorur në mënyrë të paligjshme certifikatën dhe logon e certifikimit.

Ligji i Shqipërisë do të zbatohet vetëm për marrëdhëniet juridike që ekzistojnë midis aplikantit dhe organit të certifikimit. Juridiksioni dhe vendi i kryerjes është Tirana.

Këto rregullore certifikimi kanë hyrë në fuqi më

Rregulloret e certifikimit zbatohen për të gjitha certifikatat e lëshuara gjatë periudhës së vlefshmërisë.

Ndryshimet e ardhshme të këtyre rregulloreve të certifikimit mund të ndikojnë në certifikatat ekzistuese.

Aplikanti do të informohet për këtë me shkrim nga organi certifikues

Administratori